



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

Nr. 02-400/01-0031545/25 dt. 30.05.2025

Mitrovicë

NJOFTIM

Në mbështetje të nenit 68, paragrafi 68.3 të Ligjit Nr. 03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës; nenin 61, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 03/L-048 Për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë; në nenin 25 dhe 26 të Statutit të Komunës; nenit 17, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4, nenit 19, nenit 22, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 Për Administratë të Hapur në Komuna; bazuar në Rregulloren Komunale për Transparencë, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës znj. Vesa Broja në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës, Drejtorinë për Buxhet dhe Financa dhe Zyrën për Informim ORGANIZON:

KONSULTIM PUBLIK

PËR

KORNIZËN AFATMESME BUXHETORE 2026-2028

Njoftohen të gjithë qytetarët, grupet e interesit dhe palët tjera të interesuara që të marrin pjesë në Konsultimin Publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2026-2028.

Konsultimi publik do të mbahet të **mërkurën** më dt. **11.06.2025** në Sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës duke filluar nga ora **14:00**.

Njëkohësisht të gjithë qytetarët dhe të interesuarit tjerë në afatin prej 15 ditësh nga dita e publikimit të këtij njoftimi të gjitha propozimet, komentet, vërejtjet, sugjerimet dhe pikëpamjet mund t'i bëjnë përmes ueb faqes së Komunës <https://mitroviceejugut.rks-gov.net/>, te Udhëheqësi i Sekretarisë së Kuvendit z. Nazmi Jashari në e-mailin: nazmi.jashari@rks-gov.net, ose drejtpërdrejtë në Zyrën pritëse dhe Zyrën Nr. 60 të Sekretarisë së Kuvendit të Komunës, ku edhe mund të merret Korniza Afatmesme Buxhetore 2026-2028.

Kornizën Afatmesme Buxhetore 2026-2028 po ashtu mund ta gjeni të publikuar në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut duke klikuar linkun: <https://mitroviceejugut.rks-gov.net/dokumentet-per-konsultim-publik/>.

Mitrovicë



Kryesuesja e Kuvendit

Vesa BROJA